



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
"SKODRINON" SH.A.

Nr 357 prot,

Shkodër, më 07 . 07 . 2025

V E N D I M

Nr. 11 , datë 07 .07.2025

PËR ZMADHIM TË KAPITALIT THEMELTAR TË
SHOQËRISË AKSIONARE "SKODRINON "SH.A"

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionare "SKODRINON" sh.a., me aksionar të vetëm Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, në mbledhjen e datës 07 .07 .2025, me propozim të Këshillit të Administrimit të shoqërisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.8.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, neni 135, pika 2 shkronja "ë", dhe pika 3, neni 168, neni 173, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 20.7.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare " BIO STRAJCA " sh.a., si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e akt themelimit dhe statutit", në referim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 28, datë 29.05.2025 " Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare " Bio Strajca" në pronësi të bashkisë Shkodër", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 29, datë 29.05.2025 " Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionare në pronësi të Bashkisë Shkodër me NIPT M369240030, Vendimit të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 30, date 29.05.2025 "Për një shtesë në VKB Nr.76, datë 19.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2025 të Ministrisë së Financave", statutin e shoqërisë, neni 7, gërma d), si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga " SKODRINON " sh.a., :

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare "SKODRINON " sh.a, me vlerën prej **40.000.000 lekë** (*dyzet milion*), duke nënshkruar 4 (*katër aksione*) aksione me vlerë nominale 10.000.000 (*dhjetë milion*) lekë për aksion.
2. Kapitali themeltar i "SKODRINON" sh.a., rritet me 4 (*katër*) aksione, dhe bëhet 50 000 000 (*pesëdhjetë milion*) lekë
3. Numri total i aksioneve të "SKODRINON" bëhet 5 (*pesë*) aksione.
4. Burimi i financimit është buxheti i bashkisë Shkodër miratuar me VKB nr. 30, datë 29.05.2025.
5. Depozitimin e këtij vendimi në QKB, bashkë me Vendimin nr. 30, datë 29.05.2025 të Këshillit Bashkiak Shkodër.
6. Vendimi Nr.8 datë 09.06.2025 i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë *shfuqizohet*.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i shoqërisë .

PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME
PËRFAQËSUAR
KRYETAR
BENET BECI

1

Benet
Beci

Digitally signed by
Benet Beci
Date: 2025.07.07
12:31:38 +0200